



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, dëshmitari i 12-të i thirrur nga Prokuroria dha dëshminë e tij të hënën dhe të martën e kësaj jave, duke iu përgjigjur pyetjeve të Prokurorisë dhe të ekipeve të Mbrojtjes. Dëshmitari dëshmoi me masa mbrojtëse lidhur me ndalimin dhe keqtrajtimin e tij të pretenduar nga anëtarë të UÇK-së më 1998. Duke marrë parasysh se dëshmia u dha kryesisht në seancë private, dhe për të garantuar seanca më publike, Trupi Gjykes autorizoi Prokurorinë që të lexonte përmbledhjen e dëshmisë së dëshmitarit në seancë publike.

Dëshmia e dëshmitarit të 13-të, i thirrur nga Prokuroria filloi të martën dhe po vazhdon. Dëshmitari, dëshmia e të cilit është publike, është z. Rustem Mustafa, ish-komandat i Zonës Operative të Llapit të UÇK-së.

Seancat në këtë gjykim do të vazhdojnë nesër dhe javën e ardhshme deri të enjten, më 20 korrik.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Prokuroria përfundoi paraqitjen e provave të veta të enjten, më 6 korrik 2023. Në të njëjtën ditë, Mbrojtja njoftoi për synimin e vet për dorëzimin e mocionit për rrëzimin e disa akuzave kundër të akuzuarit, si dhe për synimin për paraqitje të provave të veta. Trupi Gjykes caktoi të enjten, 24 gusht, ora 16:00, si afat për mocionin për rrëzimin e disa akuzave dhe urdhëroi Prokurorinë dhe Mbrojtësin e Viktimave që t'i përgjigjen mocionit, nëse dëshirojnë, deri të hënën, më 4 shtator.

Sipas Rregullores së Procedurës dhe të Provave para DHSK-së, menjëherë pas mbylljes së paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar, Mbrojtja informon trupin Gjykes për synimin e vet për dorëzimin e një mocioni për rrëzimin e ndonjë akuze, apo të gjitha akuzave në aktakuzë. Gjykatësit mund të vendosin që të rrëzojnë disa, ose të gjitha akuzat e aktakuzës, në qoftë se konstatojnë se nuk ekzistojnë prova në mbështetje të një vendimi fajësie jashtë dyshimit të arsyeshëm.

Në pritje të vendimit mbi mocionin për rrëzimin e disa akuzave, Trupi Gjykes ka vendosur që paraqitja e provave nga Mbrojtësi i Viktimave dhe konferenca përgatitore për Mbrojtjen të mbahen ndërmjet 21 dhe 25 gushtit. Së fundi, Trupi Gjykes ka caktuar 18 shtatorin si datë në të cilën synohet të fillojë paraqitja e provave nga Mbrojtja.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 11 korrik, Trupi Gjykes autorizoi, ndër të tjera, riklasifikimin si publik të pjesëve të transkriptit të seancave të gjykimit të mbajtura në seancë private më 2 dhe 3 maj 2023. Në interes të parimit të procesit publik, gjykatësit urdhërojnë, në intervale të rregullta, rishikimin e redaktimeve dhe seancave konfidenciale, në mënyrë që informacioni të bëhet publik më vonë, kur arsyet për konfidencialitetin e tij pushojnë së ekzistuari.

Pyetje nga gazetarët

1

